



REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranuar / Dorezuar Priljena/Prodato Received/Delivery	09.12.2021	1	viti god year
Organ /Njësia Organ /Jedinita Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKM/SHCK	5940/2021		1/9



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.861/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari- kryetare, Eshref Shabani dhe Arben Mehmeti- anëtarë dhe Valentina Kaçandolli Bekteshi- Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën A.nr.861/2021 të datës 12.10.2021 të parashtruar nga ankuesit dhe të përfaqësuar nga me adresë banimi Rruga: “Dëshmorët e Kombit”, Nr.80, Komuna e Prishtinës, kundër organit të punësimit Akademia e Kosovës për Siguri Publike, në çështjen juridike “*kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjen e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 09.12.2021, mori këtë:

V E N D I M

- I. APROVOHET si e bazuar ankesa me numër A.nr.861/2021 e parashtruar nga ankuesit dhe
- II. SHFUQIZOHET Vendimi me numër 180 i datës 04.10.2021 i Drejtorit të Përgjithshëm të Akademisë së Kosovës për Siguri Publike.
- III. OBLIGOHET Drejtori i Përgjithshëm i Akademisë së Kosovës për Siguri Publike, për zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi sipas Akt Emërimit të datës 06.05.2014 është i sistemuar në vendin e punës “Udhëheqës i Departamentit për Planifikim Strategjik dhe Çështje Ligjore”

sipas Akt Emërimit të datës 01.09.2014 është i sistemuar në vendin e punës "Udhëheqës i Divizionit për Çështje Ligjore" dhe sipas Akt Emërimit të datës 04.06.2015 është i sistemuar në vendin e punës "Udhëheqës i Divizionit për Planifikim Strategjik", të cilët sipas Vendimit me numër 198 të datës 14.06.2013 të marrë nga Drejtori i Përgjithshëm i Akademisë së Kosovës për Siguri Publike janë caktuar si zyrtarë të Sekretarisë së Bordit të Akademisë së Kosovës për Siguri Publike, kështu që ankuesi është caktuar si kryesues i Sekretarisë ndërsa ankuesit dhe si anëtarë të Sekretarisë. Sipas vendimit të lartë cekur parashihet edhe kompensimi i ankuesve kështu kryesuesi të kompensohet në vlerë prej njëqindë (100) Euro ndërsa anëtarët secili në vlerë prej shtatëdhjetë (70) Euro. Drejtori i Përgjithshëm i Akademisë së Kosovës për Siguri Publike, me datë 04.10.2021 ka nxjerr Vendimin me numër protokollit 180 përmes të cilit ka obliguar ankuesit për kthimin e mjeteve të realizuara gjatë vitit 2020 në emër të Sekretarisë së Bordit të Akademisë së Kosovës për Siguri Publike, bazuar në Raportin e Auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Ministrisë së Punëve të Brendshme për vitin 2020 nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

Ankuesit të pa kënaqur me Vendimin e datës 04.10.2021 të Drejtorit të Përgjithshëm të Akademisë së Kosovës për Siguri Publike, me datë 12.10.2021 kanë parashtruar ankesë me numër të protokollit 4991/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 14.10.2021 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek organi i punësimit Akademia e Kosovës për Siguri Publike, ndërsa më datë 17.11.2021, Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Akademia e Kosovës për Siguri Publike me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka administruar këto prova: Ankesa e ankuesve e datës 12.10.2021 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Autorizimi i datës 06.10.2021 për përfaqësimin e ankuesve për Kopja e letër njoftimit dhe ID për dhe Vendimi i datës 04.10.2021 për kthimin e mjeteve; Vendimi i datës 14.06.2013 për caktimin e zyrtarëve të Sekretarisë së Bordit të Akademisë së Kosovës për Siguri Publike; Vendimi i datës 29.05.2018 me numër 01-274 i Kryetarit KD së AKK-së; Vendimi me numër 544/14 i datës 04.07.2014 i Kryetarit të Këshillit Shtetëror të Cilësisë; Vendimi i datës 11.08.2017 me referencë 674/17; Certifikata e datës 14.05.2021; Certifikatë mirënjohje për Qershor 2018; Certifikatë mirënjohje për Qershor 2018; Certifikatë mirënjohje për e datës 22.01.2019; Mirënjohje për e datës 22.01.2019; Mirënjohje për e datës 22.01.2019; Certifikatë falënderimi për nga muaji Shkurt 2016 tek muaji Nëntor 2017; Certifikatë falënderimi për nga muaji Shkurt 2016 tek muaji Nëntor 2017; Procedimi në sistemin e pagave të Akademisë së Kosovës për Siguri Publike e datës 23.07.2012; Vendimi i Kryeministrit të Kosovës i datës 09.09.2015 për rishikimin e ndarjes së shtesave të cilat realizohen nga Buxheti i Republikës së Kosovës; Kërkesa e datës 14.10.2015 për vazhdimin e pagave shtesë; Ofrimi i dorëheqjes nga ushtrimi i detyrave të Sekretarisë së Bordit; Vendimi i datës 03.12.2020 për lirim nga detyra të zyrtarëve të Sekretarisë së Bordit të Akademisë së Kosovës për Siguri Publike; Raporti i Adutimit për pasqyrat financiare vjetore të Ministrisë së

Punëve të Brendshme për vitin 2020; Vendimi i datës 04.10.2021 për kthimin e mjeteve; Raporti i Auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Inovacionit për vitin 2020; Raporti i Auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve për vitin 2020; Raporti i Auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Ministrisë së Drejtësisë për vitin 2020; Vendimi me numër 281/2013 i datës 1.06.2013 i Ministrisë së Punëve të Brendshme; Kërkesa për vazhdimin e pagave shtesë e datës 14.10.2015; Akt emërimi i ankuesit Akt emërimi i ankuesit Akt emërimi i ankuesit Vendimi i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me numër VK.nr.58/2021 i datës 24.11.2021; Letër konfirmimi i Ministrisë së Punëve të Brendshme si dhe përgjigja në ankesë nga organi i punësimit me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështjeje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët dhe ka vërtetuar se ankesa e ankuesve
dhe *është e bazuar, sepse:*

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka shqyrtuar pretendimin ankimor të ankuesve të cilët e kanë kontestuar Vendimin me numër 180 të datës 04.10.2021 të Drejtorit të Përgjithshëm të Akademisë së Kosovës për Siguri Publike, për shkak të konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, dhe rrjedhimisht ka konstatuar se pretendimi ankimor i ankuesve është i bazuar sepse Vendimi me numër 198 i datës 14.06.2013 i Drejtorit të Përgjithshëm të Akademisë së Kosovës për Siguri Publike për kompensimin e anëtarëve të Sekretarisë së Bordit është nxjerr bazuar në nenin 14 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr.04/L-053 për Akademinë e Kosovës për Siguri Publike, dhe shtesa në pagë e ankuesve ka qenë e aprovuar nga Departamenti për Administrimin e Shërbimit Civil pranë Ministrisë së Administratës Publike, institucion ky përgjegjës për politikën në fushën e pagave dhe shpërblimeve në institucionet e administratës publike. Bazuar si me lartë kolegji konstaton se ankuesit kanë qenë të emëruar nga udhëheqësi me i lartë administrativ në këtë rast Drejtori i Përgjithshëm i AKSP-se, dhe të njëjtit e kanë realizuar shtesën në page, për punën që kanë kryer.

Kolegji ka gjetur se ankuesit përmes e-mailit të datës 03.12.2020 drejtuar Zëvendësuesit të Drejtorit të Përgjithshëm të AKSP-se, kanë kërkuar dorëheqje nga Sekretaria e Bordit, dhe si rrjedhojë Drejtori i Përgjithshëm i AKSP-se, përmes Vendimit Nr.136 të datës 03.12.2020 ka aprovuar dorëheqjen e ankuesve nga Sekretaria e Bordit, dhe njëherit ka shfuqizuar Vendimin Nr.198 të datës 14.06.2013. Andaj, lidhur me pretendimin ankimor të ankuesve, Kolegji iu referuar dispozitave të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht nenit 53 paragrafi 2 ku përcaktohet se: *Anulimi i një akti administrativ ka pasoja në të kaluarën (retroaktive), ndërsa shfuqizimi i aktit administrativ ka pasoja vetëm në të ardhmen*, si dhe nenit 55 paragrafi 2 ku përcaktohet se: *“Një akt administrativ dobiprurës i paligjshëm, nëse pala përfituese është në mirëbesim, nuk mund të anulohet, por vetëm mund të shfuqizohet”*, dhe rrjedhimisht konstatohet se meqenëse ankuesit janë caktuar me vendim të udhëheqësit me të lartë administrativ të institucionit, dhe shtesa në pagë e ankuesve ka qenë e aprovuar nga Departamenti për Administrimin e Shërbimit Civil pranë Ministrisë së Administratës Publike, si dhe duke marr parasysh se Vendimi Nr.198 i datës 14.06.2013 është shfuqizuar nga



Zëvendësdirigjtor i Përgjithshëm i AKSP-se, i njëjti nuk mund të ketë pasoja juridike në të kaluarën për ankuesit, kështu që pretendimi ankimor i ankuesve është i bazuar.

Kolegji gjate shqyrtimit të shkresave të lëndës, po ashtu ka konstatuar se anëtarët e Sekretarisë së Bordit të Akademisë së Kosovës për Siguri Publike, në periudhën e kontestuar kanë dhënë kontribut dhe kanë arritur rezultate konkrete, me ç'rast Akademia e Kosovës për Siguri Publike ka avancuar si institucion dhe është akredituar nga institucionet vendore dhe ndërkombëtare. Sipas shkresave të lëndës, gjate kësaj periudhe kohore Akademia e Kosovës për Siguri Publike është akredituar nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimit, Agjencia e Kosovës për Akreditim, dhe përveç kësaj ky institucion është akredituar edhe nga IADLEST/SHBA, dhe ankuesit për punën dhe kontributin e tyre të dhënë në institucion kanë marrë mirënjohje.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nën 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrtës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.861/2021

Valentina Kaçandolli Bekteshi

Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional

Malsore GASHI BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësuesit të ankuesve
- Drejtorit të Përgjithshëm të Akademisë së Kosovës për Siguri Publike;
- Menaxherit të Personelit në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.